



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.214/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Hasan Shala anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e organizatës BIRN dhe IKS, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Alternativa, dega në Gjakovë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me datë 22.10. 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 16.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e organizatës BIRN dhe IKS, me seli në Prishtinë, ndërsa subjektit politik Alternativa, me seli në Prishtinë, dega në Gjakovë, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1.200,00(njëmijë e dyqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën **kërcënim të përmbarimit**.

A r s y e t i m

Organizata BIRN dhe IKS, me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP më datë 13.10.2017, me të cilën pretendon se kandidatja për kryetare të Komunës së Gjakovës, Mimoza Kusari-Lila, nga radhët e subjektit politik Alternativa, në rrjetin social Facebook, ka përdorur fëmijë nën moshën 18 vjeçare, në aktivitet publik me përmbajtje politike në fushën e sportit në sheshin “Beqir Kastrati” në Gjakovë. Më tej BIRN thekson se postimi i kandidates ka përmbajtje të fushatës politike zgjedhore si dhe premtime elektorale. Parashtruesi i ankesës pretendon se me këtë rast është shkelur neni 5.2 i Rregullës Zgjedhore 13/2013.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur fotografi, nga vendi ku ka ndodhur shkelja e kodit të mirësjelljes për subjekte politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët.

Në përgjigjen në ankesë të datës 14.10.2017 subjekti politik Alternativa, theksoi se ka respektuar kërkesën e PZAP-së rreth ankesës ZL.Anr.214 të datës 13.10.2017, duke fshirë të gjitha postimet që lidhen me ankesën në fjalë. Mëtej në përgjigje në ankesë thekson se ky aktivitet ka qenë i organizuar me vetë dëshirën e kapitenit të skuadrës basketbollistike dhe me pëlqimin paraprak të prindërve. Më tej subjekti politik Alternativa thekson se për të vërtetuar se janë ndërmarrë masa përmirësuese, mund të vizitoni postimet e paraqitura në ankesë nëse ndodhen ende në rrjetet sociale të kandidates për kryetare të Komunës së Gjakovës.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se Mimoza Kusari-Lila, kandidate për Kryetare të Komunës së Gjakovës, nga radhët e subjektit politik Alternativa, ka përdorur fëmijë në postimin e saj, në rrjetin social Facebook, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 5.2 të Rregullës Zgjedhore nr. 13/2013 të KQZ-së e cila përcakton: “Në fushatën e zgjedhjeve të asnjë subjekti politik të certifikuar nuk mund të përfshihen personat që nuk i kanë mbushur 18 vjet”.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat për rastin konkret duke pasur parasysh faktin se subjekti politik Alternativa, nuk merr pjesë për herë të parë në zgjedhje dhe se të njëjtit janë të njoftuar me rregullat zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre nuk e kanë pranuar shkeljen edhe pse kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi, paneli vlerësoi se gjoba e shqiptuar do të ndikon që mos të përsëriten veprimet e kësaj natyre në të ardhmen.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Zl.Anr. 214/2017 më datën 16.10.2017.



Kryesuesi i Panelit
Adnan Konushevci

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.